




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/26
Datë: 29.01.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Ministravo Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

KONCEPT- DOKUMENTI
PËR GRADIMIN DHE PAGAT E KRIJUESVE DHE PERFORMUESËVE TË KULTURËS DHE
PUNONJËSVE PROFESIONAL TË TRASHËGIMISË KULTURORE

Kapitulli 1: Hyrje

Krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për promovimin e kulturës sikurse dhe avancimi i infrastrukturës kulturore me qëllim të krijimit të kushteve adekuate hapësinore, teknike dhe profesionale¹ janë objektiva institucionale dhe njëherazi prioritete afatmesme të parapara dhe në politikat programore si dhe në dokumentet relevante strategjike.

Në këtë kuadër, fusha e kulturës dhe mbështetjes institucionale të saj, paraqitet edhe në kuadër të Vizionit Programor 2017-2021² të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht si një ndër katër shtyllat strategjike të këtij vizioni, që kështu dëshmon për rëndësinë dhe njëherazi përkushtimin institucional për mbështetjen dhe avancimin e sektorit respektiv.

Lidhur me këtë, Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahjes dhe avancimit të sektorit kulturor, ka parapara një mori masash e objektivash sikurse rishikimi përkatësisht avancimi i kornizës ligjore dhe hartimi i politikave të reja publike që garantojnë pavarësi financiare për institucionet e kulturës dhe menaxhim efikas të përgjegjësive; krijim të politikave të reja kulturore me programe në përkrahje të artistëve dhe nismave kulturore; ristrukturim dhe riorganizim të institucioneve vartëse për kulturë; promovim të kulturës dhe ngritjes së komunikimit kulturor; edukimit, aftësimin dhe

¹ Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2018-2020, fq. 57-58

² Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës-Vizioni Programor, fq. 9

pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore etj³. Gjithashtu korniza ligjore në fuqi dhe dokumentet strategjike, sikurse Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë parasheh mbështetjen e institucioneve vartëse të trashëgimisë kulturore për veprimtarinë e hulumtimit, inventarizimit, dokumentimit, përzgjedhjes, vlerësimit, mbikëqyrjes, konservimit-restaurimit, studimit dhe promovimit të trashëgimisë kulturore⁴.

Një prej çështjeve më të rëndësishme në këtë kuadër mbetet padyshim edhe mbështetja e institucione publike të kulturës dhe trashëgimisë kulturore e me theks të veçantë kapaciteteve njerëzore që mbesin parakusht në avancimin e agjendës institucionale për kulturë dhe trashëgimi kulturorë dhe performancës institucionale në përpushjen e misionit dhe fushëveprimit të institucioneve kulturore. Si rrjedhojë, çështja e statusit të krijuesve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve të trashëgimisë kulturore, në aspekt ligjor për herë të parë dhe në mënyrë specifike është trajtuar dhe definuar me Rregulloren Nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore.

Ndonëse korniza ligjore institucionale në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore ka përcaktuar dhe definuar fushëveprimin dhe mandatin institucional për institucionet respektive (Ligji për Teatrot; Ligji për Bibliotekat, Ligji për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Ligji për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve "SHOTA", Ligji për Kinematografinë, Ligji për Trashëgiminë Kulturore), rregullorja në fjalë ka bërë përcaktimin e sistemit të gradimit dhe të pagave të krijuesve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë, në mënyrë normative dhe të definuar. Kësisoj rregullorja ka përcaktuar institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit, ka përcaktuar kriteret e gradimit, kategoritë funksionale të gradimit dhe pagave si dhe procedurat e legalizimit. Në këtë mënyrë për herë të parë janë përcaktuar pagat dhe gradat e kategorive të punonjësve të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, statusi financiar i të cilëve është përmirësuar dhe me hyrjen në fuqi të Vendimit Nr. 01/176 mbi rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës në nivel 25% në pagën bazë dhe Vendimit Nr. 06/29 e datës 15.05.2015 me qëllim të pagesës së shtesës mbi përvojën e punës si dhe realizmit të të drejtave tjera që lidhen me pushimin vjetor.

Ndonëse nxjerrja e këtij akti normativ në një masë të konsiderueshme ka definuar dhe përcaktuar një morri çështjesh që kanë të bëjnë me statusin e punonjësve të kulturës sikurse gradimi, kategorizimi, legalizimi i pozitave të punës, gjatë periudhës së zbatueshmërisë janë evidentuar çështje sikurse pozicionimi jo adekuat profesional; mosgradimi në bazë të shkollimit adekuat; kompensimi karshi detyrave dhe përgjegjësive përkatëse të vendit të punës; trajtimi jo-adekuat karshi specifikave dhe përgjegjësive dhe rrezikshmërisë së vendit të punës, niveli i pagave të ulëta jo konkurruese me rajonin, legalizimi i pozitave të punës etj. Lidhur me këtë dhe adresimin e çështjeve në fjalë, është konstatuar nevoja e rishikimit të aktit normativ në fuqi që rregullon çështjen e statusit dhe pagave për kategorinë e punonjësve në institucionet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Në këtë drejtim, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit Vjetor të Punës të Qeverisë tek objektivi *Mbështetja e institucioneve me qëllim rritjen e krijimtarisë artistike* dhe në nën-objektivin 2.1 mbështetja për institucionet publike kulturore përkatësisht Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2017 ka

³ Ibid, fq. 51

⁴ Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturorë

paraparë hartimin e Koncept Dokumentit për Gradimin dhe Pagat e Krijueseve dhe Performuesëve të Institucioneve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore si një mundësi e adresimit të çështjeve të listuara përkatësisht definimit normativ e trajtimit adekuat të tyre.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Shpjegim

Që nga hyrja në fuqi e rregullores për gradimin dhe pagat e punonjësve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, përkatësisht gjatë zbatimit të këtij akti normativ janë hasur disa vështirësi si rezultat i mangësive dhe paqartësive të disa dispozitave. Për këtë arsye është parë i domosdoshëm rishikimi dhe rrjedhimisht plotësim/ ndryshimi i rregullores në fjalë.

Problemet e identifikuara gjatë periudhës së zbatimit të rregullores në fjalë janë çështjet me sa vijon: sistemi aktual i pagave dhe gradave joadekuate; statusi dhe pozicionimi jo adekuat profesional; mosgradimi në bazë të shkollimit adekuat; kompensimi karshi detyrave dhe përgjegjësive përkatëse të vendit të punës; trajtimi jo-adekuat karshi specifikave, përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së vendit të punës, problemi i pagave të ulëta jo konkurruese me rajonin; trajtimi i pabarabartë brenda institucioneve, pengesa procedurale e ne kundërshtim edhe me ligjet bazike.

Një ndër problemet e evidentuara është dhe mos kategorizimi sipas kategorive të parapara në Rregulloren 05/2011, ku është evidentuar më specifikisht mos plotësimi i pozitave të parapara në nenin 8 dhe 9 të rregullores, në fjalë, rishikimi i kategorive (nën kategorive) të veçanta, legalizimi i pozitave të punës të punonjësve në institucionet e trashëgimisë kulturore, nivelizimi, dhe rregullim jo i mire i shtesave etj.

Në këtë kuptim, rishikimi i pagave aktuale të punonjësve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të jetë veprim kyç për të arritur objektivat e përcaktuara në politikën programore për kulturë e trashëgimi kulturore. Ky rishikim do të jetë një hap më pranë për të arritur objektivat të përcaktuara në kornizat e përgjithshme të politikës kulturore në Kosovë.

Pagat e ulëta në institucionet kulturore publike të Republikës së Kosovës janë pengesë e madhe në sigurimin e brezit të ardhshëm të profesionistëve të kësaj fushe. Me sigurimin e një page bazë konkurruese me rajonin do të kontribuojmë në konkurrencë dhe interesim më të madh të punëtorëve profesionistë të kulturës për angazhim në institucionet publike të kulturës.

Çështjet e listuara më sipër kanë ndikuar sektorin e punonjësve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Institucionet që ballafaqohen me këto probleme dhe të listuara në Rregulloren nr. 05/2011, konkretisht janë me sa vijon:

1. Institucionet e kulturës: Teatri Kombëtar i Kosovës; Baleti i Kosovës; Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "Shota"; Filharmonia e Kosovës; Galeria e Arteve të Kosovës; Kosovafilmi; Qendra Kinematografike e Kosovës; dhe

2. Institucionet e trashëgimisë kulturore: Instituti Arkeologjik i Kosovës; Muzeu i Kosovës; Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore.

Politika aktuale

Çështja e statusit të krijueseve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve të trashëgimisë kulturore trajtohet dhe definohet me Rregulloren tanimë në fuqi për Gradimin dhe Pagat e Krijueseve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore.

Rregullorja Nr. 05/2011 përcakton sistemin e gradimit dhe të pagave të krijuesve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë, në mënyrë normative dhe të definuar. Kështu rregullorja përcakton institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit, kriteret e gradimit, kategoritë funksionale të gradimit dhe pagave si dhe procedurat e legalizimit.

Kategoritë funksionale të gradimit dhe gradat e pagës në institucionet e përfshira në nenin 4 dhe 5 të kësaj Rregulloreje, përcaktohen duke u bazuar në specifikat dhe arritjet kulturore, artistike dhe profesionale. Bazuar në legjislacionin në fuqi ekzistojnë deri në tri kategori të gradimit në kuadër të cilave ekzistojnë nënkategoritë dhe janë të aplikueshme për punonjësit e institucioneve të kulturës si në vijim: punonjësit e Teatrit Kombëtar i Kosovës, Baletit të Kosovës, Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", Filharmonisë së Kosovës; Galerisë së Arteve të Kosovës, Kosovafilmi dhe Qendrës Kinematografike e Kosovës.

Duke pasur parasysh specifikat e përafërta të punës dhe organizimin e brendshëm të institucioneve të trashëgimisë kulturore, kategoritë dhe gradat e pagës së këtyre institucioneve, rregullorja ka definuar dhe përcaktuar gradat, kategoritë dhe emërtimet për punonjësit e trashëgimisë kulturore në institucionet vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit sikurse punonjësit e Institutit Arkeologjik të Kosovës, Muzeut të Kosovës; Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore dhe Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore.

Vlen theksuar gjithashtu që në kuadër të rregullores së lartpërmendur në aspekt normativ është përcaktuar çështja e pagesave shtesë mbi pagën bazë, ndonëse dispozita në fjalë nuk ka gjetur zbatim praktik që nga hyrja në fuqi e rregullores. Në këtë kuadër krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe punonjësit profesional të trashëgimisë kulturore që kanë grada shkencore Dr dhe Mr.sc dhe MA parashihet të marrin pagesë shtesë. Për gradën akademike Dr. merret pagesë shtesë në vlerë prej 200 € dhe për gradën akademike Mr.sc. dhe Ma. merret pagesë shtesë në vlerë prej 100 €.

Një çështje me rëndësi që ka paraparë rregullorja është çështja e legalizimit me automatizëm të vendeve të punës në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore. Neni 19 i Rregullores Nr. 05/2011 ka përcaktuar kriteret dhe mekanizmat sikurse Komisioni ad-hoc për Verifikimin dhe Legalizimin e Pozitave në Institucionet e Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore. Por ajo çfarë është evidentuar gjatë zbatueshmërisë së kësaj rregullore është fakti që ende ka punonjës, pozitave të cilëve ende nuk janë legalizuar.

Ligjet dhe aktet nënligjore:

1. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës, dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës.

2. Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale, qëllim të këtij ligji, institucionet e administratës qendrore dhe komunale, që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji përfshijnë: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale.

Në bazë të këtij ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategorinë e krijuesve dhe përformuesve të artit dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale.

3. Ligji Nr. 04/L - 106 për Teatrot

Ky ligj garanton të drejtën e lirisë krijuese për të gjitha format dhe shprehjet artistike skenike dhe njëkohësisht rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, drejtimin, menaxhimin dhe financimin e teatrove, pozitën e artistëve teatrorë dhe çështje të tjera të rëndësishme për teatrot. Fushëveprimi i këtij ligji përfshin veprimtarinë teatrorë, përgatitjen dhe shfaqjen publike të veprave dramatike dhe të performansave të ndryshme skenike. Ky ligj nuk e rregullon statusin e punonjësve të kulturës e as pagat e tyre.

4. Ligji Nr. 04/L-097 për Bibliotekat

Ky ligj përcakton parimet dhe normat themelore të veprimtarisë bibliotekare, të organizimit dhe funksionimit të bibliotekave.

Me këtë ligj rregullohen llojet e bibliotekave, veprimtaria e bibliotekave, struktura, organizimi dhe financimi i bibliotekave, funksionet dhe përgjegjësitë e bibliotekave, zhvillimi dhe përpunimi i koleksioneve, rrjeti Bibliotekar i Kosovës. Ky ligj nuk rregullon statusin e shërbyesve brenda bibliotekës e as pagesat e tyre. I njëjti përcakton mënyrën e zgjedhjes së drejtorit të BKK-së dhe kompetencat e tij.

5. Ligji Nr. 04/L-164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për ansamblet e tjera

Ky ligj përfshinë rregullimin e veprimtarisë kulturore-artistike, përgatitjen e shfaqjeve, veprave koreografike, këngëve, valleve dhe vlerave të trashëgimisë shpirtërore materiale. Me këtë ligj rregullohet funksionimi i veprimtarisë kulturore dhe artistike të Ansambllit kombëtar të këngëve dhe valleve "Shota" dhe të ansambleve të tjera, llojet, themelimi, organizimi, financimi, pozita e artistëve dhe çështje të tjera të kësaj veprimtarie.

6. Ligji Nr. 02/L-59 për Filarmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës

Me këtë ligj rregullohet themelimi, vazhdimësia, puna, organizimi, veprimtaria dhe funksionimi i institucioneve të Filarmonisë, Operës dhe Baletit në Kosovë. Në veçanti rregullohet: Themelimi, vazhdimi i punës dhe i veprimtarisë së filarmonisë, operës dhe baletit; Rregullimi dhe organizimi i tyre i brendshëm; Udhëheqja dhe drejtimi i tyre; Statusi, të drejtat dhe detyrat e punonjësve të filarmonisë, operës dhe baletit; Çështjet tjera të rëndësishme për veprimtarinë e filarmonisë, operës dhe baletit.

7. Ligji Nr. 2004/22 për Kinematografinë

Ky ligj, përkatësisht Neni 1, përcakton normat themelore për ushtrimin dhe mbarëvajtjen e kinematografisë.

Aktet nënligjore

Aktet normative që kanë për qëllim të rregullojnë këto çështje janë:

1. Rregullorja - nr. 05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore
2. Rregullorja Nr 02/2016 për Pagesat Shtesë të Artistëve dhe Stafit Tekniko-Artistik të FOK-së dhe Pagesat e të Angazhuarve të Tjerë në Koncertet e Filarmonisë - Operës së Kosovës.
3. Rregullorja Nr. 05/2016 për Stimulimin dhe Përgjegjësit në Punë të Artistëve Rezident dhe të Stafit Teknik në Teatrin Kombëtar të Kosovës.
4. Rregullorja Nr. 06/2016 për Pagesat e Honorarëve të Artistëve të Angazhuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës.
5. Rregullorja Nr. 06/2017 për Caktimin e Institucioneve Publike të Trashëgimisë Kulturore Vartëse të MKRS-së, në cilësinë e institucioneve kompetente.

Programi aktual

Programi aktual që është i lidhur me këtë çështje përbëhet nga korniza aktuale ligjore. Aktet normative që kanë për qëllim të rregullojnë çështjet lidhur me gradimin dhe pagat janë:

Rregullorja nr. 05/2011 për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore:

Kjo rregullore bënë përcaktimin e sistemit të gradimit dhe të pagave të krijuesve dhe te performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore që punojnë në institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore. Përcaktimin e institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit, përcaktimin e kriterëve të gradimit, kategoritë funksionale të gradimit dhe pagat, procedura e legalizimit.

Rregullorja Nr 02/2016 për Pagesat Shtesë të Artistëve dhe Stafit Tekniko-Artistik të FOK-së dhe Pagesat e të Angazhuarve të tjerë në Koncertet e Filarmonisë - Operës së Kosovës

Me këtë rregullore përcaktohen përfituesit e pagesave shtesë, kushtet dhe kriteret, përgjegjësitë si dhe mënyra e pagesave shtesë për artistët e FOK-së dhe bashkëpunëtorëve të tjerë të angazhuar në projekte të Filarmonisë- Operës së Kosovës. Përfituesit të cilët mund të marrin pagës shtesë sipas kësaj Rregulloreje, kushtet dhe kriteret për angazhimin e artistëve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë në koncertet artistike të FOK-së, përgjegjësit e organeve drejtuese të Filarmonisë- Operës së Kosovës për mënyrën e angazhimit të artisteve dhe bashkëpunëtorëve të tjerë me kontratë mbi vepër, pagesat dhe përshkrimet e pozicioneve të artisteve të angazhuar me kontratë mbi vepër FOK.

Rregullorja Nr. 05/2016 për Stimulimin dhe Përgjegjësit në Punë të Artistëve Rezident dhe te Stafit Teknik në Teatrin Kombëtar të Kosovës:

Me këtë Rregullore rregullohen kategoritë, kushtet, kriteret, procedurat, përgjegjësitë si dhe mënyra e pagesave të punës shtesë për artistët rezident dhe stafin teknik të Teatrit Kombëtar të Kosovës (në tekstin e mëtejme TTK), kategoritë e artisteve rezident me punë të përhershme si dhe angazhimin e tyre me punë shtesë/shfaqje, përgjegjësit e organeve drejtuese të Teatrit Kombëtar të Kosovës për mënyrën e angazhimit dhe trajtimit të artisteve rezident, pagesat dhe përshkrimet e pozicioneve të artistëve dhe stafit të angazhuar me punë të rregullt dhe punë shtesë/shfaqje/ në TTK.

Rregullorja Nr. 06/2016 për Pagesat e Honorarëve të Artistëve të Angazhuar në Teatrin Kombëtar të Kosovës:

Me këtë Rregullore rregullohen kategoritë, kushtet, kriteret, procedurat, përgjegjësitë si dhe mënyra e pagesave të honorarëve për artistet e angazhuar me shërbime të veçanta për projektet e Teatrit Kombëtar të Kosovës (në tekstin e mëtejme TTK), kategoritë e artisteve që angazhohen me honorar, përgjegjësit e organeve drejtuese të Teatrit Kombëtar të Kosovës për mënyrën e angazhimit dhe trajtimit të artisteve me shërbime të veçanta, pagesat dhe përshkrimet e pozicioneve të artistëve me shërbime të veçanta në TTK.

Strategjia Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027 është një strategji gjithëpërfshirëse e Qeverisë së Kosovës në fushën e trashëgimisë kulturore, e cila synon vendosjen e kornizave afatgjata për vizionin dhe ofrimin e zgjidhjeve të bazuara në parimin e qëndrueshmërisë. Ky dokument strategjik synon avancimin e sistemit dhe të mekanizmave për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës në përputhje me kornizën ligjore, parimet dhe standardet ndërkombëtare, si dhe mbi bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor.

Shpenzimet aktuale

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	1,158,837.44	1,163,614.88	1,168,485.26
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Financimi nga donatorët	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Përvoja në shtetet tjera

Në Bashkimin Evropian, nuk ekziston një politikë e unifikuar apo një kornizë ligjore e përbashkët që rregullon pagat dhe gradimin e krijuesve dhe performuesve. Fusha e kulturës sipas traktateve të BE-së, është përcaktuar kryesisht si kompetencë e vendeve anëtare, përkatësisht e vendeve që aspirojnë anëtarësimin në BE. Roli i BE-së në fushën e kulturës konsiston në promovimin e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve kulturor të vendeve të ndryshme të BE-së, apo në përplotësimin e aktiviteteve të tyre. BE-ja implementon masat e caktuara në mbështetje të iniciativave kulturore sikurse: Programi i Evropës Kreative dhe Iniciativa e Ditëve të Trashëgimisë Kulturore dhe e Kryeqytetit Evropian të Kulturës. Megjithatë, Bashkimi Evropian nuk ka një kompetencë të veçantë në këtë fushë. Sipas Nenit 167 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, BE duhet të nxisë bashkëpunimin midis shteteve anëtare dhe, nëse është e nevojshme të mbështesë dhe plotësojë veprimet e tyre në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore me rëndësi evropiane.

Nisur nga kjo rezulton që BE-ja nuk ka legjisllacion mandator në fushën e kërkuar, që nënkupton se hartimi i akteve ligjore për gradimin dhe pagat e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore, është politikë nacionale.

Sido që të jetë sipas një hulumtim të praktikave të vendeve rajonale e atyre evropiane sikurse Bullgaria, Republika Çeke, Sllovenia, Kroacia e Maqedonia, vërehet që statusi lidhur me gradat e posaçërisht pagat e punonjësve të kulturës e trashëgimisë kulturore dallon nga vendi në vend.

Bullgari

Në vitin 2016, paga mesatare vjetore në sektorin (publik)te kulturës, sipas të dhënave nga Agjencia Nacionale e Statistikave, ishte 8 966 leva (4583.15 Euro), paga mesatare në "sektorin e arsimit" ishte 10 670 leva (5454.18 Euro) dhe 9 769 leva (4993.62 Euro) nësektorin "profesional, shkencor dhe aktiviteteve teknike".

Republika Çeke

Kultura punëson 3.3% e punëtorëve në tregun e punës, do me thënë rreth 85500 njerëz, dhe volumi i prodhimit të sektorit të kulturës e përfaqëson 1.6% të prodhimit të përgjithshëm në Republikën Çeke. Paga totale mesatare në sektorin e kulturës në vitin 2013 ishte 24431CZK (904 Euro) në muaj, që është më shumë se 7% më e ulët se mesatarja kombëtare. Paga mesatare mujore në fushën e trashëgimisë kulturore është pak mbi 19 000 CZK (703 Euro), në fushën e reklamave dhe shtypit kjo është më shumë se 27 000 CZK (999 Euro) dhe në fushën e teknologjisë audiovizuale dhe interaktive është më shumë se 34 000 CZK (1258 Euro).⁵

Sllovenia

Sipas të dhënave të Entit të Statistikave të Sllovenisë në vitin 2013 kane qene te punësuar 24436 punëtorë në kulturë, nga të cilat 17 743 janë të punësuar në institucione publike, sektorin privat, ndërsa 6 693 ishin të

⁵<http://www.nipos-mk.cz/wp-content/uploads/2010/01/V%C3%BDsledky-%C3%BA%C4%8Dtu-kultury-%C4%8CR-za-rok-2013.pdf>

vetë-punësuar. Numri i punonjësve të kulturës në Slloveni arrin në rreth 3% të të gjithë fuqisë punëtore në ekonominë sllovene, dhe ka qenë vazhdimisht në rritje në përqindje prej 2000-2010. (Burimi: Ministria e Kulturës RS), duke arritur në 2.48% në vitin 2002, 2.63% në 2005 2.75% në vitin 2008, 2.92% në vitin 2009, 3.04% në vitin 2010 dhe 3.09% në vitin 2011 dhe 2012.

Tabela 1: Numri i punonjësve të punësuar kulturore dhe të vetë-punësuar, 2005-2013

Viti	Persona të punësuar në kulturë	Personat e vetëpunësuar në kulturë	Numri total të punëtorëve në kulturë
2005	17 480	3 942	21 422
2006	17 975	4 154	22 129
2007	18 401	4 366	22 767
2008	19 248	4 986	24 234
2009	19 080	5 556	24 636
2010	18 889	5 977	24 866
2011	18 629	6 203	24 832
2012	18 314	6 179	24 493
2013	17 743	6 693	24 436

Tabela 2: Paga mesatare bruto në sektorin e kulturës 2000-2005 dhe indekset e rritjes

Viti	Paga Mesatare Bruto (Euro)	Indeksi i rritjes
2000	990.01	
2005	1 358.71	106.54 (përaf. 2000-2005)
2006	1 399.93	103.03
2007	1 471.91	105.14
2008	1 594.37	108.32
2009	1 662.14	104.25
2010	1 694.90	101.97

Tabela3 : Pagat mesatare bruto në profesione të ndryshme 2005-2010

Viti	Paga mesatare bruto EUR: Aktivitete kulturore – të gjitha	Punëtorët e sektorit publik në kulturë	Punëtorët në profesionet jo-kulturore në Slloveni	Mjekët (në spitale)	Mësimdhënësit (shkolla e mesme)	Mësuesit (universitet)	Gjyqtarët
2005	1 358.71	1 398.31	1 157.07	1 427.54	1 553.60	1 928.88	1 539.76
2006	1 399.93	1 445.64	1 212.80	1 473.24	1 622.67	1 951.05	1 560.38
2007	1 471.91	1 491.97	1 284.79	/	/	/	/
2008	1 594.37	1 644.38	1 391.43	1 737.51	1 795.89	2 136.69	1 737.91
2009	1 662.14	1 765.56	1 438.96	1 993.54	1 852.93	2 245.68	1 822.10

2010	1 694.90	1 795.17	1 494.88	1 987.72	1 868.26	2 316.91	1 831.95
------	----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Në vitin 2003, u miratua Ligji për sistemin e pagave në sektorin publik. Ky ligji vendos një sistem të unifikuar të pagave për të gjithë shërbyesit civilë dhe publikë. Arsyeja kryesore për miratimin e këtij ligji ishte unifikimi i sistemit të pagave. Në shtator të vitit 2008 zbatimi i sistemit të ri arriti në fazën përfundimtare dhe pagat për punonjësit kulturorë publikë u rritën me 16%, që i sjelli ato në përputhje me pagat e tjera publike.

Maqedoni:

Në gusht të vitit 2017 sipas Zyrës Shtetërore të Statistikave të Maqedonisë, paga mesatare neto për punëtor (në muaj) në sektorin e kulturës ishte 21 948 MKD, e cila është e barabartë me 356.44 euro krahasuar me atë në arsim që ishte 22 285 MKD apo 361.88 euro.

22	22	22	100.4	100.0	100.3	100.3	P	EDUCATION
285	251	292						
22	22	22	100.4	100.0	100.3	100.3	85	Education
285	251	292						
24	24	24	101.7	100.5	100.4	101.6	Q	HUMAN HEALTH AND SOCIAL WORK ACTIVITIES
992	919	958						
27	27	27	101.8	100.5	100.6	101.7	86	Human health activities
108	028	071						
19	19	19	101.7	102.0	100.2	102.1	87	Residential care activities
529	362	416						
16	16	16	100.8	100.1	99.5	100.7	88	Social work activities without accommodation
790	749	801						
21	20	21	104.0	110.8	110.9	103.0	R	ARTS, ENTERTAINMENT AND RECREATION
948	927	590						
22	22	22	100.4	99.7	99.7	100.2	90	Creative, arts and entertainment activities
318	308	341						
20	20	20	99.2	100.8	99.0	99.4	91	Libraries, archives, museums and other cultural activities
351	299	275						
19	19	19	109.9	108.2	110.0	108.4	92	Gambling and betting activities
982	459	076						
40	30	42	92.0	180.1	171.2	87.9	93	Sports activities and amusement and recreation activities
556	079	359						
26	26	27	102.7	99.3	103.4	102.7	S	OTHER SERVICE ACTIVITIES
843	778	009						

34 513	34 545	34 637	101.8	99.7	103.3	102.2	94	Activities of membership organisations
19 766	18 983	19 480	106.9	102.2	108.0	102.1	95	Repair of computers and personal and household goods
18 405	18 260	18 494	104.5	99.6	102.8	104.0	96	Other personal service activities

Në bazë të të dhënave të siguruara nga institucionet kulturore të rajonit, pagat e performuesëve të institucioneve publike (aktorëve) janë në këto nivele:

Pagat e aktorëve të Teatrove Kombëtarë (të Rajonit janë):

- Kroacia – 1080 – 1400
- Sllovenia 1600 – 1800
- Bosnja – 900 – 1100
- Serbia – 1000 – 1200
- Maqedonia – 850 – 1000

Cilat qasje mund të kenë sukses në Kosovë

Sido që të jetë sipas një hulumtim të praktikave të vendeve rajonale e atyre evropiane sikurse Bullgaria, Republika Çeke, Sllovenia, Kroacia e Maqedonia, vërehet që statusi lidhur me gradat e posaçërisht pagat e punonjësve të kulturës e trashëgimisë kulturore dallon nga vendi në vend. Pra nuk ka një model unik të cilit do të mund të i referoheshim, mirëpo nëse shohim nivelin pagave të shteteve të rajonit, punonjësit janë të kategorizuar në nivel të punëtorëve tjerë profesionalë si: Profesorët universitar, gjyqtarët, mjekët, etj.

Duke marr parasysh praktikat e vendeve të propozuara më lartë Kosova duhet të përcaktohet për një zgjidhje të qëndrueshme (si rasti i Sllovenisë) lidhur me çështjen e pagave, gradimit, dhe kategorizimit të punonjësve të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Kapitulli 3. Synimet dhe objektivat

Synimi

Përmirësimi i statusit të krijuesve, përformuesve dhe punonjësve profesional - shkencor të trashëgimisë kulturore me institucionet tjera profesionale publike.

Objektivat

- Harmonizimi dhe nivelizimi i gradave dhe pagave të punonjësve të kulturës dhe atyre të trashëgimisë kulturore.
- Rishikimi i pagave të krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore.
- Ngritja e nivelit të performancës të institucioneve të kulturës dhe të trashëgimisë kulturore dhe e punonjësve brenda këtyre institucioneve.

Adresimi i objektivave do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në procesin e kategorizimit dhe gradimit të punonjësve duke ridefinuar kategoritë ekzistuese, pozicionimin adekuat profesional, gradimit në bazë të shkollimit adekuat, trajtimit të barabartë brenda institucioneve, trajtim adekuat karshi specifikave dhe përgjegjësive si dhe rrezikshmërisë së vendeve të punës, çështjen e pagave, për të gjithë punonjësit e institucioneve publike të kulturës dhe trashëgimisë të parapara me Rregulloren 05/2011.

Në referencë të planit të punës së Qeverisë, dhe të listës së Koncept Dokumenteve, koncept dokumenti që trajton çështjen në fjalë është paraparë të përfundohet dhe të dorëzohet në Qeverinë e Republikës së Kosovës gjatë vitit 2017.

Kapitulli 4. Opsionet

Opsioni i 1. Status quo (asnjë ndryshim)

Në qoftë se ruhet status quo-ja, atëherë do të vazhdojë të mbetet i padefinuar dhe jo i zbatueshëm në tërësi sistemi aktual i gradave dhe kategorive, statusi dhe pozicionimi jo adekuat i profesioneve, mos gradimi në bazë të shkollimit adekuat, mos kompensimi karshi i detyrave dhe përgjegjësive të vendit të punës, si dhe problemi i pagave të ulta jo konkurruese me rajonin. Andaj nëse vazhdohet me implementimin e politikës ekzistuese, përkatësisht duke zbatuar Rregulloren Nr. 05/2011, me këtë status do të kemi një disharmoni në paga dhe gradat ndërmjet krijuesve dhe performuesve dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore dhe gjithashtu do të kemi edhe performancë jo të duhur në përmbushjen e politikave të institucioneve përkatëse kulturore.

Opsioni 2. Ndryshimi i politikës ekzistuese

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit konsideron se politika ekzistuese duhet të ndryshohet, përmes plotësimit dhe ndryshimit të Rregullores Nr. 05/2011, me qëllim të përmirësimit të statusit dhe pozicionimit adekuat profesional, gradimit në bazë të shkollimit adekuat, kompensimit karshi detyrave dhe përgjegjësive të vendit të punës, si dhe rishikimit të pagave jo konkurruese me rajonin.

Miratimi i rregullores së plotësuar dhe ndryshuar të sjellë ndryshime të konsiderueshme në efikasitetin dhe transparencën e të gjithë procesit të gradimit dhe pagave të krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore.

Përgjegjës për zbatimin e politikës së re do të jetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me institucionet vartëse të kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Plotësim ndryshimi i rregullores nuk kërkon personel shtesë, por vetëm do të bëhet nivelizimi i gradave dhe pagave. Politika e re do të ju komunikohet institucioneve vartëse dhe punonjësve konform Rregullores së Punës së Qeverisë dhe Rregullores për Standardet Minimale të Konsultimit Publik.

Opsioni i 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Me ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit do të mund të trajtoheshin vetëm çështjet sikurse shtesat në pagë dhe plotësimi i vendeve të parapara me rregullore, deri më sot të pa plotësuara. Zbatimi i qasjes ekzistuese mund të bëjë zgjidhje të pjesshme të problemeve, por nuk bënë zgjidhjen e problemeve kryesore lidhur me nivelzimin e gradave dhe pagave të punonjësve të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Për ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit, përgjegjës do të jetë Ministria e Kulturës dhe institucionet vartëse.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos marrja e ndonjë veprimi për ndryshim të politikës dhe situatës aktuale.	Përmirësimi i situatës me plotësim-ndryshimin e Rregullores në fuqi.	Përmirësimi i situatës përmes ndryshimit të qasjes ekzistuese të zbatimit të rregullores në fuqi.
Spektori			
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës për zbatim.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet vartëse në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore	Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet vartëse në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet vartëse në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit.	////	/////	/////

Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese, si dhe zbatimi dhe dënimet.	Rregullorja Nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijuesëve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore	Plotësim ndryshimi i rregullores në fuqi.	Rregullorja Nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijuesëve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat.	/////	////////	////////
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	/////	////////	////////
Udhëzimet dhe kodet	/////	////////	/////
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni.	Rregullorja është në fuqi	2017/18	2018

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni 1 - Edhe përkundër mangësive që ka treguar zbatimi i kësaj rregullore në praktikë, megjithatë kjo rregullore ka bërë përcaktimin e sistemit të gradimit dhe të pagave të krijuesve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve profesional të trashëgimisë, në mënyrë normative dhe të definuar. Kësisoj rregullorja ka përcaktuar institucionet e kulturës dhe të trashëgimisë kulturore të cilat përfshihen në procesin e gradimit, ka përcaktuar kriteret e gradimit, kategoritë funksionale të gradimit dhe pagave si dhe procedurat e legalizimit.

Opsioni 2 - Përmes plotësim-ndryshimit të rregullores do të adresoheshin dhe trajtoheshin këto çështje: gradimi dhe kategorizimi i definuar i punonjësve të institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore, pozicionimi adekuat profesional, gradimi në bazë të shkollimit adekuat, kompensimi karshi detyrave dhe përgjegjësive përkatëse të vendit të punës, trajtimi adekuat karshi specifikave përgjegjësive dhe rrezikshmërisë së vendit të punës, pagave konkurruese, trajtimi i barabartë brenda institucioneve etj.

Opsioni 3- Nëse politika ekzistuese nuk ndryshohet, por sigurohet ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit, do të definoheshin disa çështje që pjesërisht do të ndikonin në përmirësimin e situatës aktuale të sistemit së gradave dhe pagave të punonjësve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Pasojat negative

Opsioni 1 - Vazhdimi i politikës ekzistuese do të shkaktonte thellimin e problemeve aktuale të definuara.

Opsioni 2 - Me nxjerrjen e plotësim ndryshimit të rregullores aktuale paraqitet nevoja për kosto shtesë buxhetore.

Opsioni 3 - Me ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit, gjendja nuk do të ndryshonte substancialisht.

Efekti shpërndarës

Më përjashtim të ndikimit të Institucioneve Publike të Kulturës dhe të Trashëgimisë, politika aktuale dhe ajo e propozuar nuk ndikon në sektorët tjerë, zonat rurale ose urbane, grup moshat dhe gjinitë.

Kosto

	Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar			
	(000 Euro)			
	Viti aktual2017	Viti 2018	Viti 2019	
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	1,163,614.88	1,168,485.26	1,173,280.03	
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Financimi i pritur nga donatorët	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	1,163,614.88	1,752,727.89	1,759,920.05	
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Financimi i pritur nga donatorët	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	1,163,614.88	1,268,485.26	1,273,280.03	
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	
Financimi i pritur nga donatorët	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	

Aneks- tabelë e veçantë e ndikimi financiar të secilit opsion

Kapitulli 7: Konsultimi

Në procesin e hartimit të këtij Draft Koncept Dokumentit janë konsultuar ekspert, punonjës nga institucionet publike të kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe përfaqësues sindikal (Shoqata Sindikale e Teatrit Kombëtar të Kosovës). Procesi i konsultimit do të bëhet në pajtim me rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë dhe Rregulloren Nr.05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1. -Status-quo-ja - me vazhdimin e kësaj situatë gjendja do mbetet e pa ndryshuar. Statusi i krijueseve, performuesëve dhe punonjësve profesional të trashëgimisë kulturore me rregulloren nëfuqi mbetet i mangët, jo i definuar tërësisht dhe kësaj do të ndikojë dhe në performancën institucionale dhe programore.

Opsioni 2. - Me plotësim-ndryshimin të rregullores- do të zgjidhen problemet esenciale dhe definohen çështjet kryesore të cilat sot hasin në vështirësi të shumta siç janë: sistemi aktual i pagave dhe gradave joadekuate; statusi dhe pozicionimi jo adekuat profesional; mosgradimi në bazë të shkollimit adekuat; kompensimi karshi detyrave dhe përgjegjësive përkatëse të vendit të punës; trajtimi jo-adekuat karshi specifikave, përgjegjësive dhe rrezikshmërisë së vendit të punës, problemi i pagave të ulëta jo konkurruese me rajonin; trajtimi i pabarabartë brenda institucioneve etj.

Opsioni 3. - Me ndryshimin e qasjes ekzistuese të zbatimit, do të evidentoheshin disa përmirësime, mirëpo gjendja në sistemin e gradimit dhe kategorizimit, legalizimit të vendeve të punës e që konsiderohen ndër problematikat kryesore nuk do të ndryshonte fare.

Opsioni i cili do të ketë mundësi më së shumti që të arrijë synimin dhe objektivat tona për zgjidhjen e çështjeve të identifikuar, është plotësim-ndryshimi i Rregullore 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijueseve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionale të Trashëgimisë Kulturore.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, të miratojë Koncept Dokumentin me opsionin e dytë (2) të rekomanduar, respektivisht plotësim-ndryshimin e Rregullore 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijueseve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të rregulloj çështjet e sistemit të pagave, gradimit dhe kategorizimit të krijueseve, performuesëve të kulturës dhe punonjësve të trashëgimisë kulturore.

Ky opsion do të ketë implikime buxhetore, të cilat si të tilla janë të paraqitura në formularin e vlerësimit të ndikimit financiar. Në rast të miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me institucionet vartëse të kulturës dhe trashëgimisë dhe akterët respektiv do të hartoj dhe procedoj për miratim në Qeveri Projekt Rregulloren për plotësim-ndryshim e Rregullores 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijueseve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore. Hartimi dhe procedimi për miratim do të bëhen gjatë vitit 2017.

Kapitulli 10: Komunikimi

Me miratimin e këtij koncept dokumenti, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit sipas rregullave dhe procedurave, do t'u komunikoj palëve të interesit vendimin e Qeverisë për ndryshimet që do të bëhen lidhur me sistemin e kategorizimit, gradimit dhe pagave të punonjësve profesional të kulturës dhe trashëgimisë kulturore. Mënyra e komunikimit do të jetë konform Rregullores së Punës së Qeverisë dhe Rregullores Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik. Mesazhi kryesor do të jetë njoftimi për mundësitë e reja që do t'i sjellë plotësim/ndryshimi i rregullores.

Ky Draft Koncept Dokument u është dërguar për konsultim paraprak sipas nenit 7 (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë të gjithë akterëve relevant, në pajtueshmëri me procedurat e përcaktuara. Të gjitha rekomandimet e marra janë shqyrtuar në këtë Draft Koncept Dokument.

11. Projekt vendimi i Qeverisë

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesëve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.